



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 401/3 Prot.

Tiranë, më 18/04/2023

VENDIM

Nr. 23, DATË 18/04/2023

MBI

**“FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E KANDIDATURAVE PËR NGRITJEN
E KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i), nenin 46 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30, pika 3(a) dhe nenin 31 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pika 2(a) dhe neni 22 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pikat 1(t) dhe 1(s) të Rregullores së Funkcionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidaturave për anëtarë në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Arteve.
2. Komisioni përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 31, pika 3 të Statutit të UART:
 - a. Të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - b. Të mbajnë titullin “Profesor” dhe të kenë së paku pesë vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli.
4. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A dhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 26.04.2023.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5. Ky vendim t'i njoftohet njësisve kryesore të UART dhe të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve si dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI


Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genc FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT, P/A

KËRKESË PËR KANDIDIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

Unë, i/e nënshkruar/i/a _____, lindur më ___/___/_____, në _____, të rrethit _____, gjinia _____, paraqes kërkesën time për të kandiduar për anëtar të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, në zgjedhjet e muajit prill 2023, si përfaqësues i Fakultetit _____.

Në përputhje me Statutin e Universitetit të Arteve, miratuar me vendim të Senatit Akademik Nr. 15, datë 30.08.2021, nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se:

- Jam pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
- Mbaj titullin “Profesor” dhe kam së paku pesë vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli.

Kësaj kërkesë i bashkëngjitet:

- Kopja e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kopja e noterizuar e titullit “Profesor” që unë zotëroj;
- Vërtetimi i qendrës time të punës;
- Vërtetimi që nuk kam marrë masë disiplinore.

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij formulari do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

Aplikuesi

Emër, Mbiemër, Firmë

U dorëzua më datë ___/___/_____, pranë Zyrës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A.

